



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 11.5.2023

Nr: 496

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**VLERËSIMIN E RAPORTEVE TË MONITORUESVE TË FUSHATËS ZGJEDHORE PËR PERIUDHËN  
E MONITORIMIT 9 MAJ DERI MË 10 MAJ 2023**

Sot më datë 11 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në seancë publike pasi shqyrtova çështjen me:

**OBJEKT:** Vlerësimi i raportit të monitoruesve të fushatës zgjedhore për periudhën 9 maj deri më 10 maj 2023.

**BAZA LIGJORE:** Neni 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” dhe pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe udhëzimi nr. 6, datë 23.03.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**KONSTATOJ:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka caktuar 120 (njëqind e njëzet) monitorues për fushatën zgjedhore të datës 14 maj 2023.

Monitoruesit e fushatës zgjedhore mbikëqyrin përmbushjen e detyrimeve nga subjektet zgjedhore në lidhje me financimin e fushatës dhe detyrimeve të tjera që përcaktohen në Kodin Zgjedhor. Monitorimi përfshin periudhën 4 muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Për periudhën 9 maj 2023 deri më 10 maj 2023 janë administruar 45 (dyzet e pesë) raporte monitorimi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Data: 11.5.2023 Nr: 496  
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raporteve të monitoruesve të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 9 maj deri më 10 maj 2023”

Nga vlerësimi që i është bërë gjetjeve në këto raporte për periudhën 9 maj deri më 10 maj 2023, rezulton se 4 prej tyre pasqyrojnë shkelje mbi hapjen e zyrave zgjedhore nga subjektet zgjedhore “Partia Socialiste e Shqipërisë” dhe “Lëvizja Bashkë”. Zyrat zgjedhore janë hapur afër KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve në shkelje të nenit 5, pika 1, të udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili përcakton se “Zyrat zgjedhore të subjekteve zgjedhore mund të hapen në një distancë jo më të vogël se 300 (treqind) metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve”.

Më konkretisht janë raportuar shkeljet nga subjektet zgjedhore si më poshtë vijon:

### **1. Për subjektin zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”:**

Janë hapur zyra zgjedhore në një distancë jo më të vogël se 300 (treqind) metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve në:

- a) Bashkinë Fier, 80 m nga shkolla “Liri Gero”. Raporti i monitoruesit me nr. unik 49654674, datë 10.05.2023.
- b) Bashkinë Fier, 140 m nga shkolla “Perikli Ikonomi”. Raporti i monitoruesit me nr. unik 26220890, datë 10.05.2023.
- c) Bashkia Lushnjë, Njësia Administrative Golem, qendra e votimit rezulton të jetë edhe zyrë zgjedhore. Raporti i monitoruesit nr. unik 91000126, datë 09.05.2023

Sot më datë 11.5.2023, monitoruesi i Bashkisë Lushnjë risolli raport monitorimi ku konstaton se zyra zgjedhore e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” në qendrën e votimit nr. 2826 në Golem, është mbyllur si dhe janë hequr materialet propagandistike.

### **2. Për subjektin zgjedhor “Lëvizja Bashkë”:**

Është hapur zyrë zgjedhore në një distancë jo më të vogël se 300 (treqind) metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve në:

- a) Bashkinë Tiranë, 20 m nga shkolla “Avni Mula”. Raporti i monitoruesit me nr. unik 89617660, datë 10.5.2023

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” dhe pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

## V E N D O S:

1. Urdhërimin e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake Fier për mbylljen e menjëhershme të zyrave zgjedhore, si vijon:
  - Zyra zgjedhore afër qendrës së votimit shkolla “Liri Gero”, Bashkia Fier;
  - Zyra zgjedhore afër qendrës së votimit shkolla “Perikli Ikonomi”, Bashkia Fier.
2. Urdhërimin e subjektit zgjedhor “Lëvizja Bashkë”, Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake Tiranë për mbylljen e menjëhershme të zyrës zgjedhore, si vijon:
  - Zyra zgjedhore afër qendrës së votimit shkolla “Avni Mula”, Bashkia Tiranë.
3. Ky vendim u njoftohet subjekteve zgjedhore “Partia Socialiste e Shqipërisë” dhe “Lëvizja Bashkë”, Policisë së Shtetit si dhe Policive Bashkiake Tiranë dhe Fier nëpërmjet postës elektronike.
4. Ngarkohen për zbatim të menjëhershëm të këtij vendimi subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, subjekti zgjedhor “Lëvizja Bashkë”, Policia e Shtetit dhe Policinë bashkiake Tiranë dhe Fier.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**